

## **PROGRAMI I CIKLIT TË DYTË NË ADMINSTRATËN PUBLIKE**

Fakulteti i Administratës Publike ofron studime të ciklit të dytë që shpiejnë deri në magistraturë në lëmën e Administratës Publike. Studimet, do të përqëndrohen në Administratën Publike Krahasuese (Komparative) në Unionin European.

### **I. PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM**

Programi i ciklit të dytë në UEJL të orienton në aftësitë që duhet të fitohen dhe kompetencat që duhet të arrihen me qëllim që studentët të përgatiten dhe në mënyrë konstruktive të kontribuojnë në shoqëri, përmes karrierave të tyre si menaxherë, këshilltarë dhe analistë të politikave në organizatat qeveritare dhe joprofitabile.

### **II. Rezultatet e studimeve**

Aftësitë që do të përvetësohen me anë të këtyre programeve mund ndahen në dy lloje: në aftësi veprimi (intelektuale dhe transferuese) dhe teknike (të bazuara në njohuri). Sipas programit të zgjedhur rezultatet nga mësimi mund të ndahen në tri grupe kryesore:

#### **Aftësi**

Aftësi në punë me kompjuter, njohje të gjuhëve, argumentim, aftësi të zgjidhjes së konflikteve, shkrim akademik, aftësi të prezantimit, njohuri bazë nga matematika, punë ekipore, fleksibilitet dhe vetëtrajnim.

#### **Njohuri**

Metodologjia e shkencave shoqërore, sistemi ligjor, sistemi juridik, strukturat institucionale, sistemi politik dhe partitë politike, sistemi ekonomik, institucionet dhe ligjet e UE, qeverisja lokale dhe shtetërore, menaxhimi dhe teoria organizative.

#### **Kompetencat**

Kërkime shkencore, komunikim profesional, miratim i vendimeve, zgjidhja e problemeve, etika publike, mendimi kritik-aftësi për vlerësim kritik dhe informacione të komunikimit, të cilat janë të dobishme për zgjidhjen e problemeve praktike, përpilimi i politikave, raportet me publikun, aftësi për identifikimin e problemeve rrjedhëse, buxhetimi, sistemi tatimor, menaxhimi financiar, analizë kuantitative.

### **III. Përshkrim i programit dhe planit mësimor**

Programi i ciklit të dytë përmban 90 kredi ECTS dhe do të realizohet në bazë të studimeve të rregullta në kohëzgjatje prej 3 semestreve (30 kredi në semestër). Programi përfshin katër lëndë obligative të katedrës, gjashtë lëndë obligative nga Administrata Publike Krahasuese (Komparative) dhe Administrata Europiane; puna praktike në organizata të njohura publike, private apo joprofitabile dhe punim të magistraturës, të bazuar në punë kërkimore.

Programi përbëhet prej planit mësimor si vijon::

<b>Semestri 1</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>▪ Metodologjia e kërkimit (6 kredi) (Etem Aziri, Zoran Matovski)</li><li>▪ Politika publike dhe menaxhimi (6 kredi) (PARIS 12)</li><li>▪ Administrata publike krahasuese (komparative) (6 kredi) (PARIS 12, as. Memet Memeti)</li><li>▪ Statistikë për menaxherët në sektorin publik (6 kredi) (Ajet Ahmeti)</li><li>▪ Lëndë zgjedhore (6 kredi)</li></ul>
-------------------	--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

Në semestrin e parë përfshihen lëndët zgjedhore që vijojnë:

- Historia e administratës publike (6 kredi) (Ibrahim Gashi)
- Studime të avancuara të konstitucionalitetit evropian (6 kredi) (Blerim Reka, as. Arta Ibraimi)

<b>Semestri 2</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>▪ Sistemet politike krahasuese (comparative) ( 6 kredi ) (Etem Aziri)</li><li>▪ Studime europiane të avansuara: e drejta, politika dhe institucionet në UE (6 kredi) (Blerim Reka, as. Arta Ibraimi)</li><li>▪ Struktura e administratës në UE (6 kredi) (Paris 12, )</li><li>▪ Pasqyrë krahasuese (comparative), të AP në Europë; Franca (6 kredi) (Paris 12)</li><li>▪ Lëndë zgjedhore (6 kredi)</li></ul>
-------------------	----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

Në semestrin e dytë përfshihen lëndët zgjedhore që vijojnë:

- Sociologjia e shoqërisë europiane (6 kredi) (Etem Aziri, Zoran Matovski)
- Kushtet dhe procedura për anëtarësim në Unionin Europian (6 kredi) (Blerim Reka, as. Arta Ibraimi)

<b>Semestri 3</b>	<ul style="list-style-type: none"><li><input type="checkbox"/> Puna praktike (5 kredi)</li><li><input type="checkbox"/> Puna kërkimore (5 kredi )</li><li><input type="checkbox"/> Punimi i magjistraturës (capstone) (20 kredi)</li></ul>
-------------------	--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

#### IV. Kushtet e regjistrimit

Përveç kushteve të përgjithshme për regjistrim në programet e ciklit të dytë të studimeve në Universitetin e EJL, kandidatët për t'u regjistruar në këtë program duhet të plotësojnë edhe kushtet që vijojnë:

- Diplomë deridiplomike (universitare) në: administratë publike, juridik, shkenca politike, komunikim, sociologji dhe ekonomi (180-240 kredi)
- Njohje të gjuhës shqipe, maqedonase dhe angleze.

- Notë mesatare së paku 8.00 apo dy punime të gjëra të publikuara në revista ndërkombëtare profesioniste të njohura.
- Mendim pozitiv të Komisionit për pranim (për studentët me diploma në lëmë të tjera mund të kërkohet t'u nënshtrohen provimeve plotësuese nga studimet deridiplomike)
- Intervistë

#### **V. Ligjërues:**

Ligjërues nga Paris 12

Ligjërues nga Paris 12

Ligjërues nga Paris 12

Ligjërues nga Paris 12

Blerim Reka

Etem Aziri

Zoran Matevski

Ibraim Gashi

Ajet Ahmeti

**Asistent**

Arta Ibraimi

Memet Memeti